



Pranuar / Received	25-03	2022	2	viti / year
Organ Njësia / Organ Unit	SKIMSHTOK	1597/2022	116	Sasia / Quantity

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.109/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca -anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.109/2022 të datës 10.02.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë banimi: [redacted], Komuna e Deçanit, kundër organit të punësimit Komuna e Pejës, në çështjen juridike „kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 25.03.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.109/2022 e datës 10.03.2022, e parashtruar nga ankuesja [redacted]
- II. Mbetet në fuqi vendimi me nr. protokoli 01-112/01-0004681/22 i datës 14.01.2022 i Komisionit të Pranimit.

**A r s y e t i m**

Ankuesja [redacted] ka aplikuar në konkursin e datës 25.11.2021-09.12.2021 për pozitën “Specialistë ligjor” me nr. reference RN00007844 në Komunën e Pejës, e cila i është nënshtruar testit me shkrim me datë 22.12.2021 dhe intervistës me gojë e mbajtur me datë 31.12.2021. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës me datë 10.01.2022 ka shpallur listën përfundimtare për kandidatët fitues të cilët kanë arritur mbi 70 pikë.

Ankuesja e pakënaqur me njoftimin e datës 10.01.2022 ,me të njëjtën datë ka parashtruar ankesë në Komisionin e Pranimit. Komisioni i Pranimit me vendimin e datës 14.01.2022 me numër protokoli 01-112/01-0004681/22 refuzon si të pabazuar ankesën e ankueses.

Kundër vendimit të datës 14.01.2022 me numër protokollit 01-112/01-0004681/22 ankuesja ka parashtruar ankesën përmes postës me datë 09.02.2022 e cila në Këshill ka ardhur me datën 10.02.2022 me numër të protokollit 655/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 18.02.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Pejës. Ndërsa me datë 28.02.2022 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesa e ankueses e datës 10.02.2022 me numër protokollit 655/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 14.01.2022 me numër protokollit 01-112/01-0004681/22 i Komisionit të pranimit; Ankesa e datës 10.01.2022 e parashtruar Komisionit të Pranimit; Rezultatet e vlerësimit , grupi specialist ligjor i datës 10.01.2022; Diploma e datës 30.11.2016 me nr.4226 e lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" Çertifikatë e datës 28.12.2018 me të cilën dëshmohet se [redacted] e ka dhënë provimin e jurisprudencës me datën 15.10.2018; Vërtetim i datës 05.01/017 GJA.nr.8/017 i lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-dega në Glllogoc; Letër rekomandimi e datës 23.09.2019; Vërtetim i datës 17.10.2018 e lëshuar nga Fakulteti Juridik me të cilën dëshmohet se e njëjta është në semestri e II në Master drejtimi civil; Referencë e datës 04.01.2017; Rekomandim i datës 13.10.2015; Referencë nga Komuna e Glllogocit; Diplomë e datës 30.02.2006; Diplomë e datës 07.01.2006; Diplomë e datës 15.10.2005; Diploma e muajit gusht 2011; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit i datës 28.02.2022 me numër protokollit 1070/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Vendimi i datës 10.03.2021 i Kryetarit të Komunës së Pejës; Kopja e konkursit e datës 25.11.2021-09.12.2021 për pozitën Specialist ligjor; Aplikacioni i datës 02.12.2021 për R. L; Vërtetim i datës 02.12.2021; Vërtetim i datës 04.02.2021 e lëshuar nga avokati H. M; Diploma e datës 25.10.2016 me nr.347 e lëshuar nga Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka" e noterizuar me nr.977/2018; Kontratë pune për kohë të caktuar e datës 01.02.2017 në Institutin e Kosovës për Drejtësi; Vërtetim për punë i datës 26.02.2018; Marrëveshje për Shërbime të veçanta e lidhur me datën 06.09.2018; Pasqyra e llogarisë së trustit prej datës 01.01.2002 22.01.2020; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 08.01.2019 në Komunën e Pejës; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 16.08.2019 në Komunën e Pejës; Vërtetim i datës 06.09.2021: Kopja e letërnjoftimit; Raport pune në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa e datës 30.05.2019; Raport pune në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa e datës 01.10.2018; Çertifikatë e datës 26.11.2021 i lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë; Aplikacioni për Sh. D i datës 09.12.2021; Diplomë e datës 05.10 2007, nr.171 e lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës ; Licencë për ndërmjetësues e datës 14.07.2014; Vërtetim i datës 21.07.2012 me nr.190; Kopja e letërnjoftimit; Vërtetim i datës 21.07.2012 me nr.191; Çertifikatë e datës 07.12.2021 i lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë; Aplikacioni i datës 01.12.2021 për A. Sh; Diplomë e datës 27.08.2004; Diploma e datës 13.05.2011 e lëshuar nga Kolegji AAB-Rinvest; Diploma Master i Drejtësisë e datës 01.03.2019 e lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin "Haxhi Zeka" Pejë; Çertifikatë e muajit shkurt 2006; Çertifikatë e datës 12.09.2014 me nr.03/2436 e lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës; Vërtetim mbi kryerjen e Praktikës në Komunën e Pejës e datës 29.03.2018 ; Vërtetim mbi përvojën e punës i datës 09.11.2021 me nr.11/2021;

Vërtetim mbi përvojën e punës e datës 03.12.2021 i lëshuar nga N.P.Sh. "Unismetal" kopja e letërnjoftimit; Çertifikatë e datës 30.11.2021 i lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë; Aplikacioni i datës 04.12.2021 për [redacted] Diploma e datës 30.11.2016 me nr.4226 e lëshuar nga fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës; Vërtetimi i datës 05.01.2017 e lëshuar nga Gjykata Themelore Prishtinë-dega në Glllogoc; Çertifikatë e datës 28.12.2018 me të cilën dëshmohet se [redacted] e ka dhënë provimin e jurisprudencës me datën 15.10.2018; Referencë e datës 04.01.2017; Vërtetim mbi marrëdhënien e punës e datës 05.09.2021 e lëshuar nga Avokati F. B; Letër rekomandim i datës 23.09.2019; Diplomë e datës 03.12.2005 për aftësimin me kompjuter; Diplomë e datës 07.01.2006 për aftësimin me kompjuter; Diplomë e datës 15.10.2005 për aftësimin me kompjuter; Diplomë e datës 13.02.2006; Letër rekomandim e datës 23.09.2019; Referencë e datës 04.01.2017; Lista e kandidatëve të aprovuar dhe kandidatëve të refuzuar; Rezultatet preliminare të verifikimit paraprak të kandidatëve grupi specialist ligjor i datës 13.12.2021; Njoftim i datës 20. 12.2021 ; Vendimi i datës 13.12.2021 me nr.aplikacioni RAN0001986 për mos përfshirje në listën e ngushtë për F. B; Vendimi i datës 13.12.2021 me nr.aplikacioni RAN0001733 për mos përfshirje në listën e ngushtë për M. G; Vendimi i datës 13.12.2021 me nr.aplikacioni RAN0001970 për mos përfshirje në listën e ngushtë për V. P; Vendimi i datës 13.12.2021 me nr. aplikacioni RAN0001744 për mos përfshirje në listën e ngushtë për D. M; Vendimi i datës 13.12.2021 me nr.aplikacioni RAN0001738 për mos përfshirje në listën e ngushtë për R.V; Vendimi i datës 13.12.2021 me nr.aplikacioni RAN0001647 për mos përfshirje në listën e ngushtë për A. M; Vendimi i datës 13.12.2021 me nr.aplikacioni RAN0001989 për mos përfshirje në listën e ngushtë për K. V; Vendimi i datës 09.12.2021 me nr.01-112/02-0132241/21 i nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Pejës për formimin e Komisionit të Pranimit në Shërbimin Civil në Komunën e Pejës; E-maillet zyrtare të datës 20.12.2021 njoftimi për mbajtjen e testit me shkrim me datën 22.12.2021 për pozitën Specialist ligjor; Fletëdorëzimi për njoftimin për testin me shkrim për R. L; Fletëdorëzimi për njoftimin për testin me shkrim për Sh. D; fletëdorëzimi për njoftimin për testin me shkrim për [redacted] fletë dorëzimi për njoftimin për testin me shkrim për A. SH; fletë dorëzimi për njoftimin për testin me shkrim për A. K.; fletëdorëzimi për njoftimin për testin me shkrim për Sh. M; Vlerësimi i aplikacionit; E-mail zyrtar i datës 28.12.2021 , njoftim për mbajtjen e intervistës me gojë me datën 31.12.2021; fletëdorëzimi i datës 28.12.2021, njoftim për mbajtjen e testit me gojë për Sh. D; Fletë dorëzimi i datës 28.12.2021, njoftim për mbajtjen e testit me gojë për R. L; Fletëdorëzimi i datës 28.12.2021, njoftim për mbajtjen e testit me gojë për A. Sh; Fletë dorëzimi i datës 28.12.2021, njoftim për mbajtjen e testit me gojë për [redacted] Vlerësimet e intervistës me gojë të datës 31.12.2021 nga anëtarët e komisionit të pranimit për A. Sh; Vlerësimet e intervistës me gojë të datës 31.12.2021 nga anëtarët e komisionit të pranimit për R. L; Vlerësimet e intervistës me gojë të datës 31.12.2021 nga anëtarët e komisionit të pranimit për Sh. D; Vlerësimet e intervistës me gojë të datës 31.12.2021 nga anëtarët e komisionit të pranimit për [redacted] Rezultati përfundimtar për kandidatët për pozitën specialist ligjor ; Rezultatet e vlerësimit , grupi specialist ligjor i datës 10.01.2021; Ankesa e datës 10.01.2022 e parashtruar në Komisionin e pranimit nga [redacted] Vendimi i Komisionit të Pranimit i datës 14.01.2022 me nr.protokoli 01-112/01-0004681/22 dhe E-mail zyrtar i datës 14.01.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankueses [redacted] është e pabazuar *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, sipas shkresave të lëndës ka gjetur se Komuna e Pejës me datë 25.11.2021 ka shpallur konkursin për pozitën "Specialistë ligjor" bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Sipas konkursit me numër reference RN00007844 sipas njoftimit të datës 04/11/2021, i shpallur me datë 25.11.2021, për pozitën Specialist ligjor në Komunën e Pejës, si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar si vijon:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare në juridik të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me te,*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy(2) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave ka konstatuar se për këtë pozitë kanë aplikuar trembëdhjetë (13) kandidatë, ndërsa në listën e ngushtë janë përzgjedhur gjashtë(6) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesja e cila për këtë pozitë të punës, ka aplikuar me datë 02.12.2021 e cila ka marrë pjesë në testin me shkrim dhe testin me gojë, por nuk është përzgjedhur nga Komisioni i Pranimit sepse nuk i ka pasur mbi 70 pikë siç është përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës " ku kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë janë kandidatë fitues, ndërsa ankuesja në total ka pas 69.56 pikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se procedura e rekrutimit sipas njoftimit të datës 04/11/2021, i shpallur me datë 25.11.2021, për pozitën Specialist ligjor në Komunën e Pejës e datës 25.11.2021-09.12.2021 me nr. reference RN00007844 , është zhvilluar në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-212 e Punës, Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se ky pretendim i ankueses është i paqëndrueshëm sepse e gjithë procedura e konkurrimit është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës e jo në bazë të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës së cilit i referohet ankuesja dhe mbi këtë bazë përveç pretendimit të përgjithësuar mbi shkeljen e këtyre dispozitave të lartshënuara nuk kemi ndonjë specifikë të konstatimit të ndonjë shkelje ligjore konkrete të identifikuar nga vetë ankuesja.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankueses se gjatë testimit me shkrim i cili është mbajtur me datë 22.12.2021 një nga kandidatet ju ka nënshtruar këtij testi pa asnjë mjet identifikimi, dhe të gjithë kandidatët fitues kanë qenë ulur njëri pran tjetrit dhe në testin me shkrim Komisioni ju ka ndihmuar duke ua treguar përgjigjet, ky pretendim i ankueses është i paqëndrueshëm dhe

nuk mund të argumentohet me asnjë provë nga shkresat e lëndës që janë dorëzuar nga ankuesja dhe se kandidatët janë verifikuar nga komisioni i pranimit paraprakisht dhe poashtu në aplikacion është e bashkangjitur edhe fotoja e kandidatit, fakt i pranuar edhe nga ankuesja në këtë ankesë, në sallën e intervistimit gjenden kamerat e sigurisë, por se nuk është ofruar asnjë dëshmi nga ankuesja për të argumentuar këtë fakt, andaj si i tillë pretendimi është i pabazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar edhe po ashtu pretendimin tjetër ankimor të ankueses e cila pretendon se gjatë intervistës me gojë nuk jam vlerësuar drejtë dhe se komisioni i ka thënë që të përgjigjet sa ma shkurt, kolegji konstaton se edhe në lidhje me këtë pretendim ankuesja me asnjë provë nuk ka arritur të dëshmojë një pretendim të tillë pasi ky pretendim është i natyrës subjektive, përkundrazi komisioni ankueses ja ka mundësuar të përgjigjet aq sa ajo e ka konsideruar se është e nevojshme, konstatim i dhënë edhe në vetë arsyetimin e vendimit të komisionit të pranimit i cili nuk është kontestuar nga ankuesja në ankesë.

Kolegji duke marrë në konsideratë edhe pretendimet tjera të ankueses, duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe rrethanave të konfirmuara nga përmbajtja e ankesës vërtetohet fakti se e njëjta nuk ka marrë pikët e mjaftueshme mbi bazë të arsyeve të ndryshme sipas pretendimit të saj por që për kolegjin nuk ishin relevante këto pretendime për faktin se nuk ndikojnë në vendimmarrje sa i përket objektit të kësaj ankesë për arsyet e specifikuar më lartë, mbi këtë bazë vendimi me nr. protokolli 01-112/01-0004681/22 i datës 14.01.2022 i Komisionit të Pranimit është nxjerrë në harmoni me legjislacionin në fuqi të shërbimit civil.

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se procedura e konkursit sipas njoftimit të datës 04/11/2021 i shpallur me datë 25.11.2021 për pozitën Specialist ligjor në Komunën e Pejës me nr. reference RN00007844, është zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.


Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda.A.nr.109/2022, datë 25.03.2022

Sabile AVDYLI



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- ❖ Ankueses [REDACTED]
- ❖ Kryetarit të Komunës së Pejës;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së

